

SKEDA E GJYKIMIT NË TRE SHKALLË

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

Xhezair ZAGANJORI	- Kryesues
Evelina QIRJAKO	- Anëtar
Medi BICI	- Anëtar

Në datën 26.02.2015 mori në shqyrtim në Dhomën e Këshillimit çështjen administrative me nr.11241-02140-00-2012 akti që u përket palëve:

PADITËS

ARTAN VINA

I PADITUR:

KOMUNA POJAN

OBJEKTI: Detyrimi i palës së paditur të më dëmshpërblejë me pagën e tre muajve për mosrespektim të afatit të njoftimit, pagën e dy muajve për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës së punës, pagën e gjashtë muajve të parashikuara në kontratë, e cila u ndërpre në mënyrë të njëanshme, pa arsye të justifikuara, pagën e 12 muajve për zgjidhjen e kontratës pa shkaqe të arsyeshme.

BAZA LIGJORE: Nenet 143, 144, 145, 146, 148, 153, 155 të Kodit Punës dhe nenet 32/a e 154 të K.Pr.Civile.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Korçë, me vendimin nr.362, datë 07.02.2012 ka vendosur:

Pranimin pjesërisht të kërkesëpadisë së paditësit Artan Vina.

Detyrimin e palës së paditur Komuna Pojan ti paguajë paditësit Artan Vina:

pagën deri në përfundim të aftit të kontratës, për periudhën 15.07.2011 deri me datë 30.01.2012 (5 muaj e 18 ditë);

-2 muaj pagë për mosrespektim të procedurës së zgjidhjes së kontratës;

-2 muaj pagë si dëmshpërblim për zgjidhjen e menjëhershme, të pajustificuar të kontratës së punës;

Gjithsej 9 paga dhe 18 ditë (paga mujore bruto 19.000 lekë).

Rrëzimin e kërkesëpadisë për kërkimet e tjera.

Gjykata e Apelit Korçë, me vendimin nr. 436, datë 16.05.2012 ka vendosur:

Lënien në fuqi të vendimit nr. 362, datë 07.02.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

Kundër vendimit të mësipërm, ka paraqitur rekurs pala e paditur Komuna Pojan...

Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 63/a dhe dh të ligjit nr. 49, datë 03.05.2012 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Gjykatave Administrative dhe Gjykimin e Mosmarrëveshjeve Administrative”.

V E N D O S I

Lënien në fuqi të vendimit nr. 436, datë 16.05.2012 të Gjykatës së Apelit Korçë me ndryshimin: Rrëzimin e padisë për shpërblimin e dëmit me dy muaj për zgjidhjen e menjëhershme dhe të pajustificuar të kontratës së punës.

U shpall në Tiranë, me datë 26.02.2015

Nr.11241-02140-00-2012 Regj.Themeltar
Nr.00-2015-1416 Vendimi (122)